KRONIKË

Shkatërrohet grupi i trafikut të armëve Kosovë-Shqipëri, 14 të arrestuar

Policia e Shtetit ka publikuar pamje nga sekuestrimet që ka bërë gjatë operacionit

12 dhjetor 2024 10:58

Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Një grup kriminal i trafikut të armëve që ishte aktiv në Kosovë e Shqipëri është shkatërruar pas nëntë muaj hetime nga Prokuroria Speciale e Kosovës me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Gjithsej 14 persona janë arrestuar në të dyja shtetet. Tetë të dyshuar janë arrestuar në Kosovë dhe janë dërguar në mbajtje, gjashtë prej tyre shtetas të Kosovës, ndërsa dy prej të cilëve shtetas të Shqipërisë. E, gjashtë të tjerë u arrestuan në Shqipëri.

Policia e Kosovës më 10 dhjetor ka kontrolluar nëntë prona të të dyshuarve dhe ka gjetur 29 pistoleta, tri armë të gjata të modeleve të ndryshme të konfiskuar, 2635 fishek/municion të modelit të ndryshëm, dy automjete dhe pajisje tjera.

Personat e arrestuar janë: V.O., K.K., S.H., Sh.J., A.H., Z.A., A.D., B.A.

Ndërsa, më 11 dhjetor nën drejtimin e Prokurorisë Pranë Gjykatës Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, u zhvillua operacioni për ekzekutimin e urdhrave të ndalimit për 6 persona dhe kontrolli i banesave për 7 vende. Gjatë këtij operacioni u ndaluan për veprat penale "Trafikimi i armëve dhe municionit" e kryer në bashkëpunim të 6 personave: E.M. E.P. A.M. G. Ll. K.M. dhe T.Sh.

Gjatë këtij operacioni u sekuestruan 22 armë zjarri 'Zoraki", një armë zjarri Ak 47, një granatë dore ofensive dhe 470 fishekë të llojeve të ndryshme. Gjithashtu u sekuestruan edhe 3 automjete dhe shuma të konsiderueshme parash e 10 aparate celulare.

"Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës lidhur me këtë rast njofton opinionin publik se në prill të këtij viti, kishte pranuar informacione lidhur me dyshimet se disa persona shtetas të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë, janë duke u marrë me import, eksport, furnizim, transportim, ndërmjetësim dhe shitje të paautorizuar të armëve apo materialeve plasëse.Pas pranimit të këtyre informacioneve PSRK kishte autorizuar Policinë e Kosovës, për ndërmarrjen e veprimeve hetimore, me qëllim mbledhjen e provave", thuhet në njoftimin e Prokurorisë.

Nga hetimet e zhvilluara janë dokumentuar raste të shitjes së armëve të zjarrit kryesisht pistoleta 'Zoraki" të trafikuara nga Kosova drejt Shqipërisë.

Hetimet janë mbështetur edhe nga EUROPOL-i.

#POLICIA E KOSOVËS

TaboolaFeed



Gifting Season
Free Huggie Hoops When you spend £200+. Free UK delivery on all orders
LILY & ROO | Sponsored

The Shocking Forex Lie That Could Be Costing You…
Financial News | Sponsored
Read Now

Own A Cask Of Whisky With Average Annual Returns of…
Download Our Free Guide To Supercharge Your Investment …
Whisky Partners | Sponsored
Read More



This game will kill your time! Only 3% can pass Level 8. Can you beat the pirates?
Unlock 500+ Brilliant Puzzle Levels! Find Hidden Treasure on the Island. Click Now & Start Your Adventure!
Stormshot | Sponsored
Play Now

Own A Cask Of Whisky With Average Annual Returns of…
Download Our Free Guide To Supercharge Your Investment …
Whisky Partners | Sponsored
Read More

Own A Barrel of Whisky With Average Annual Returns of…
Whisky casks are a unique and tax-efficient** investment avenue …
Whisky Investors | Sponsored
Download

This game will kill your time! Only 3% can pass Level 8. Can you beat the pirates?
Unlock 500+ Brilliant Puzzle Levels! Find Hidden Treasure on the Island. Click Now & Start Your Adventure!
Stormshot | Sponsored
Play Now

Men over 45 are going crazy about this free slot machine…
Try it now and get 150,000 free chips
Lounge 777 | Sponsored
Play Now

This game is so realistic that it's worth just watching!
Raid Shadow Legends | Sponsored

AI Bot Flips Wall Street on Its Head: Turns $1K into $50K in Record 30 Days
A new AI trading robot reportedly generated a return of $14,158 from a $3,200 investment over the course of a week, according to verified tradin…
Financial News | Sponsored



Gifting Season
Free Huggie Hoops When you spend £200+. Free UK delivery on all …
LILY & ROO | Sponsored

Women over 35 are going crazy about this free slot…
Try it now and get 150,000 Free Chips
Lounge 777 | Sponsored
Sign Up

Kjo është pozita e re të cilën Trumpi po e mendon për Grenellin
Kohanet

Bislimi tregon pse s'është në listën e kandidatëve për deputetë
Kohanet

Arbëri.
Presidenca nuk tregon nëse do t'i shqyrtojë 91 kërkesat e të burgosurve për falje

LAJMET E MBRËMJES.
PDK-ja kontestoi 16 ligje. Sipas LVV-së, opozita i frikësohet Byrosë për Konfiskimin e Pasurisë

Arbëri.
Aplikimi i Kosovës për anëtarësim në BE, në sirtar tash e dy vjet

LAJMET E MBRËMJES.
Kurti: Serbia është shtet paraushtarak – me sulme terroriste tash po i shëndeshtron civilët

WILDLIFE.
Çka thotë shkenca për fluturimin e shpendëve

Arbëri.
Osmani do ta përfaqësojë Kosovën në samitin BE-Ballkani Perëndimor

Own A Cask Of Whisky With Average Annual Returns of…
Whisky Partners | Sponsored
Read Next Story

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfardo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe internet a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjitha shkeljet e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 / info@koha.net

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhonh Bush p.n., 10000 Prishtinë